

**DEKLARATË E CAROLINE ZIADEH,
PËRFAQËSUESE SPECIALE E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM
DHE SHEFE E UNMIK-UT
DEBAT I KËSHILLIT TË SIGURIMIT PËR UNMIK-UN**

**NJU JORK
27 PRILL 2023**

z. kryetar, shkëlqesi,

Kam nderin t'i raportoj Këshillit lidhur me zhvillimet në Kosovë, të cilat në periudhën e fundit raportuese kanë përfshirë sfida të mëdha, dhe përpjekje të rëndësishme të përbashkëta për t'i sjellë marrëdhëniet mes Beogradit dhe Prishtinës më afër stabilitetit dhe normalizimit.

Do të nevojiten përpjekje nga të dyja palët që të realizohet potenciali për ndryshim pozitiv të marrëdhënieve, posaçërisht duke marrë parasysh ciklet paraprake të tensioneve, provokimeve dhe shqetësimeve që kanë ndodhur gjatë pjesës më të madhe të vitit 2022 dhe, fatkeqësisht, në disa aspekte edhe gjatë ditëve të fundit. Veprimet e efektshme, me kohë dhe parandaluese janë të renditura dhe të dokumentuara mirë në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm. Pa një përkushtim të rritur për mekanizmin e negociatave të ripërtërira, dështimet në krijimin e besimit në Kosovë mund të përkeqësohen, gjë që do të kishte pasoja të drejtpërdrejta për stabilitetin regional. Së këndejmi, një përqendrim i theksuar i vëmendjes ndaj parimeve dhe deklaratave, të mbështetura së bashku në Bruksel më 27 shkurt dhe më tej të shtjelluara më 18 mars në Ohër, duhet të përcillen me veprime të guximshme udhëheqëse nga palët dhe nga përkrahësit e negociatave.

Të dyja palët kanë dhënë përkushtime specifike ndaj “*marrëveshjes së re për rrugën drejt normalizimit mes Kosovës dhe Serbisë*”. Në vijë me këto përkushtime, ekzistojnë edhe hapat e menjëhershëm që mund të ndërmerren për të demonstruar vullnetin e mirë në terren. Arritja e përparimit kërkon rikrijimin e besimit tek ata që kanë dyshime për qëllimet e palës tjetër.

Udhëheqësit duhet të ndërmarrin hapa të përgjegjshëm lidhur me zvogëlimin e gjasave për probleme të tjera rreth çështjeve që kanë zvogëluar besimin e qytetarëve gjatë muajve të fundit. Këtu përfshihen çështjet që kanë ndikuar në tërheqjen masive të serbëve nga institucionet e Kosovës në muajin nëntor dhe ato që vazhdojnë të polarizojnë opinion publik gjatë zgjedhjeve komunale të mbajtura të dielën e kaluar. Po ashtu, duhet të ndërmerren hapa për të demonstruar që organet policore dhe të drejtësisë të jenë plotësisht të pavarura nga agjendat politike dhe ndërhyrjet politike. Do të ketë nevojë për komunikim të qartë dhe të vazhdueshëm me qytetarët lidhur me çështjet që prekin jetesën dhe të drejtat e tyre njerëzore – çështjet, siç janë shpronësimet dhe mundësia për të llogaritur tek institucionet e paanshme të drejtësisë. Gjithashtu, ka nevojë për t’u risiguruar në eliminimin e ndjenjave të mosbesimit dhe të pasigurisë që ndjejnë qytetarët e rëndomtë në të dyja anët e lumit Ibër. Retorika akuzuese duhet shmangur dhe besimi e optimizmi duhet t’ia zënë vendin frikës.

z. kryetar,

Zgjedhjet e jashtëzakonshme të 23 prillit kanë qenë të qeta. Njëkohësisht, duhet të trajtohen çështjet e përfaqësimit si pjesë e procesit më të gjerë politik që është duke u zhvilluar. Udhëheqësit e zgjedhur, forcat policore dhe të gjitha shërbimet civile në nivel komunal duhet në mënyrë të mirëfilltë të pasqyrojnë dhe të plotësojnë interesat e zgjedhësve të tyre vendorë.

Më 2 maj, pritet të miratohet nga të dyja palët deklarata e përbashkët për personat e zhdukur, e cila është lehtësuar nga BE-ja. Kjo deklaratë ka potencial për rifillimin e bashkëpunimit të plotë mes Prishtinës dhe Beogradit për personat e zhdukur në kuadër të grupit ekzistues të punës, të udhëhequr nga KNKK. Kjo do t'u jepte familjeve të të dyja palëve mundësinë e gjetjes së përgjigjeve për më të dashurit e tyre. Po ashtu, prezantimi nga ekipi menaxhues i propozimstatutit për asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe duhet të rezultojë në konsiderim të menjëhershëm, të hollësishëm dhe me vullnet të mirë të tij. Hartimi i planit të plotë të zbatimit është baza minimale që udhëheqësit ia kanë borxh qytetarëve gjatë takimit të tyre të ardhshëm të nivelit të lartë. Komiteti i përbashkët i monitorimit duhet që patjetër të dëshmojë efikasitetin në punë dhe në mbikëqyrjen e veprimeve të ndërmarra nga të dy palët.

z. kryetar,

Dëshiroj t'ju tërheq vëmendjen në faktin se ky sesion i Këshillit të Sigurimit mbahet në të njëjtën kohë me përvjetorët e rëndësishëm që i japin një perspektivë të rëndësishme zhvillimeve të fundit. Një nga këta përvjetorë është edhe 20-vjetori i samitit të Selanikut, ku BE-ja u deklaroi mbështetjen e saj të rezervuar për perspektivën evropiane të Ballkanit perëndimor. Siç është bërë e ditur, në këtë muaj shënohet 10-vjetori i nënshkrimit në Bruksel të “Marrëveshjes së parë për parimet e normalizimit të marrëdhënieve”.

Gjatë viteve pasuese, siç është theksuar në raportet e shumta drejtuar këtij Këshilli të Sigurimit, jokonsistenca e përkushtimit dhe veprimeve si nga vendorët, ashtu edhe nga ndërkombëtarët, rregullisht kanë kufizuar përparimin në avancimin e normalizimit të marrëdhënieve. Në gjysmën e dytë të vitit 2022, veprimet dhe reagimet kanë larguar Prishtinën dhe Beogradin edhe më shumë nga shtegu, për të cilin më parë ishin pajtuar brenda kornizës së dialogut të

ndërmjetësuar nga BE-ja, e madje i kanë sjellë shqetësueshëm afër konfrontimit fizik. Këto janë tendenca, ndaj të cilave udhëheqësit përgjegjës tani duhet të punojnë për t'i ndryshuar.

Në biseda të mia me palë të ndryshme - duke përfshirë përfaqësuesit komunalë, fetarë, të shoqërisë civile dhe të bizneseve - opinionet e zakonshme që hasi janë frustrimi dhe shqetësimi për të ardhmen e pasigurt. Megjithatë, njëkohësisht shoh një frymë dhe vullnet për të punuar në krijimin e një realiteti më të mirë. Këtë e çmojmë pasi që punojmë së bashku me të gjithë njerëzit që kërkojnë ndryshime pozitive dhe të prekshme.

z. kryetar,

Fqinjët në tërë regjionin, qofshin anëtarë të Bashkimit Evropian apo ata që aspirojnë të bëhen një ditë, po ashtu janë duke përcjellë zhvillimet. Tregtia dhe investimet thjesht do t'i anashkalojnë ato vise ku marrëdhëniet normale nuk ekzistojnë apo ku tensionet kërcënojnë stabilitetin themelor institucional. Udhëheqësit e regjionit kanë shprehur përkrahjen e tyre për procesin që tani po zhvillohet nga të dyja palët në rrugën drejt avancimit të normalizimit. Shumë prej tyre janë ballafaquar dhe kanë tejkaluar sfidat e tyre vetanake nga e kaluara dhe janë duke shkuar drejt arritjes së stabilitetit, pajtimit dhe përparimit. Këtë e kanë bërë përmes trajtimit të çështjeve të vështira me kreativitet dhe me ndjenjë të përgjegjësisë afatgjatë politike.

Në regjion, janë duke u shqyrtuar mundësitë për zvogëlimin e barrierave në zhvillimin dhe bashkëpunimin ekonomik përmes avancimit të nismave të rëndësishme, të cilat mund dhe duhen të përshpejtohen, duke përfshirë edhe përparimin drejt normalizimit.

z. kryetar,

Në përkrahje të këtij procesi, UNMIK-u do të vazhdoj me përpjekjet në ndihmesë të liderëve dhe zgjedhësve të tyre për të nxjerrë përfitimet e komunikimit të përmirësuar dhe mirëkuptimit të problemeve të përbashkëta, si dhe për të realizuar zgjidhjet. Dua që po ashtu të përmendi edhe një përvjetor. Ky vit shënon 5 vite të punës të agjendës së UNMIK-ut për ndërtimin e besimit. Ky program i aktiviteteve parasheh mbështetjen e njerëzve në terren që sinjerisht punojnë në avancimin e mirëbesimit mes komuniteteve dhe qëndrueshmërisë. Ky është një investim afatgjatë në ata që pozitivisht mund t'i riformësojnë marrëdhëniet në të gjitha nivelet.

Fokusi ynë është në fuqizimin e komuniteteve dhe përparimin e tyre në vendet ku ekzistojnë paragjykimet ndarëse etnike dhe retorika politike. Ndërtimi i besimit drejtpërdrejtë mund të ndihmojë në ndriçimin e rrugës drejt normalizimit politik. Marrëveshjet politike kanë nevojë për tokë pjellore ku mund të rriten dhe zhvillohen. Të gjitha këto qasje së bashku shënojnë një rrugë të vërtetë drejt një të ardhme më të qëndrueshme, paqësore dhe më përparimtare.

Rrjedhimisht, dua t'i theksoj vetëm disa mënyra përmes të cilave misioni është duke i fuqizuar kampionët e ndërtimit të besimit në tejkalimin e ndarjeve të krijuara nga keqkomunikimi dhe gjuha e shpeshtë ofenduese politike. Këtu përfshihen përkrahja e të drejtave gjuhësore dhe e të mësuarit të gjuhëve, ku platforma në internet e përkrahur nga UNMIK-u për mësimin e gjuhës shqipe dhe asaj serbe ka arritur numrin e më shumë se 70.000 përdoruesve. Gjithashtu, jemi duke u ndihmuar familjeve të personave të zhdukur përmes Qendrës së Resurseve për Persona të Zhdukur. Jemi duke promovuar dhe do të vazhdojmë të promovojmë fuqizimin e rinisë dhe grave, duke ofruar platforma domethënëse për angazhimin e tyre në të gjitha nivelet e vendimmarrjes. Po ashtu, jemi duke ndihmuar në sigurimin e qasjes së barabartë në drejtësi përmes infrastrukturës së

përmirësuar të gjykatave, ndihmës juridike falas dhe shërbimeve të përkthimit juridik.

Muajin e ardhshëm do ta inaugurojmë qendrën për dialog të komuniteteve, të krijuar dhe udhëhequr nga kampionët vendorë të ndërtimit të besimit. Ne vazhdojmë me fuqizimin e punës kohezive dhe shumësektoriale me agjencitë e OKB-së dhe me të gjithë partnerët tonë ndërkombëtarë. Së bashku, jemi duke i rritur vazhdimisht mbështetësit e kompromisit politik - përkundër të gjitha sfidave - duke treguar njëkohësisht efektet pozitive që ofron kjo rrugë në jetën e përditshme të njerëzve.

z. kryetar,

Aspirata e të gjithë ne duhet të jetë që akumulimi i përpjekjeve ndërkombëtare tani do të trasojë një rrugë reale drejt normalizimit. Pengesat e këtij procesi mund të marrin formën e marrjes së vëmendjes për qëllime politike apo të mungesës së vullnetit politik për krijimin e hapësirës së pranimit nga qytetarët. Zbatimi me siguri do të ballafaqohet me shumë ngecje dhe do të kërkojë durim. Megjithatë, asnjë nga këto ngecje nuk mund të krahasohen me përfitimet që njerëzit do të kenë përmes këmbëngulësisë dhe rezultateve.

UNMIK-u do të mbetet i përkushtuar në përkrahje të progresit për të gjitha nivelet, gjë që është ndër pjesët më të rëndësishme të mandatit tonë. Këtë do ta bëjmë në pritje që zgjidhjet e bëra nga udhëheqësit politikë, përmbushja e obligimeve dhe përkushtimeve të tyre do të çojë në mundësi më të mëdha për një brez që meriton më mirë.

Në realizimin e mandatit tonë, misioni vazhdon të mbështetet në përkrahje të këtij Këshilli në punën që bëjmë së bashku me partnerët tonë si brenda spektrit të OKB-së, ashtu edhe përtej tij.

Ju falënderoj për këtë përkrahje dhe për avancimin e zgjidhjeve që u shërbejnë interesave të brezit të ri në Kosovë dhe regjion.

Ju faleminderit.